



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NJOFTIM

PËR

**FILLIMIN E PROCESIT TË TRAJNIMIT TË VIJUESHËM PROFESIONAL TË
AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË DETYRË NË SEKTORIN PUBLIK PËR VITIN
2022**

1. Në mbështetje të urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 248, datë 31.12.2021 “Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik për vitin 2022”, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm njofton fillimin e procesit të trajnimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si dhe hapjen e procedurës së aplikimeve të kandidatëve për trajner në këtë proces.
2. Të gjithë individët që janë të interesuar për të aplikuar për trajnerë, duhet të plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Rregulloren e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik. Kandidatët duhet të zotërojnë sa më poshtë:
 - a) Të paktën diplomë “Master i shkencave” ose “Master i Arteve” dhe eksperiencë në profesion, sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 17.02.2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”;
 - b) Të paktën 2 vite eksperiencë në mësimdhënie;
 - c) Integritet moral dhe profesional;
 - d) Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi;
 - e) Aftësi për të hartuar dhe prezantuar temën sipas programit;
3. Çdo kandidat që aplikon për trajner duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesë;
 - b) Curriculum Vitae;
 - c) Fotokopje të noterizuar të diplomës universitare dhe certifikata të kualifikimeve profesionale;
 - d) Vërtetim të eksperiencës në profesion;
 - e) Vërtetim të eksperiencës në mësimdhënie;
 - f) Rekomandime për integritet moral dhe reputacion të mirë.

4. Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet zyrtarisht në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Afati i pranimit të dokumentacionit fillon në datën 25.07.2022 dhe përfundon në datën 06.09.2022.

Detaje më të hollësishme lidhur me procedurën e përzgjedhjes së trajnerëve dhe temat e parashikuara në Programin e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2022, i gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me adresë: www.financa.gov.al.